

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT

1. PËRSHKRIMI I SITUATËS

“Planveprimi për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit të Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente” për Policinë e Shtetit, i cili ndahet në dy blloqe:

Blloku i parë i Planveprimit të Drejtorisë së Policisë së Shtetit është përmirësimi i kapaciteteve për zbulimin, hetimin dhe goditjen e korrupsionit dhe përfshin objektivat e mëposhtme:

1. Përmirësimi i mekanizmave dhe mjeteve për hetimin e rasteve të korrupsionit;
2. Forcimi e zgjerimi i informatizimit, konsolidimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit;
3. Përmirësimi i procedurave për të rritur efikasitetin e ndjekjes penale;
4. Rritja e nivelit goditës së luftës kundër korrupsionit;
5. Hartimi i statistikave periodike të ecurisë së ndjekjes penale;
6. Ngritja në nivel më të lartë të bashkëpunimit ndër institucional në luftën kundër korrupsionit;
7. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet agjencive të ligjit për rastet e korrupsionit;
8. Rritja e bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit;
9. Promovimi i praktikave anti-korrupsion dhe operacioneve policore për goditjen e korrupsionit;

Blloku i dytë titullohet parandalimi i korrupsionit në Strukturën e Policisë së Shtetit dhe përfshin objektivat e mëposhtme:

1. Rritja e integritetit dhe përmirësimi i standardeve të punës të punonjësve të policisë së shtetit;
2. Reduktimi i mundësisë së punonjësit të Policisë së Kufirit dhe Migracionit (PKM) për akte korruptive nëpërmjet minimizimit të transaksioneve të ligjshme financiare në Pikat e Kalimit të Kufirit (PKK);
3. Rritja e kapaciteteve të punonjësve të PKM për luftën kundër korrupsionit në kufi nëpërmjet trajnimeve;
4. Monitorimi on-line i aktivitetit të punonjësve të PKM në PKK;
5. Kontrolli i aktivitetit të punonjësve të PKM në PKK për rregjistrimin e hyrje-daljeve të shtetasve dhe mjeteve.
6. Identifikimi i rrugëve dhe metodave për uljen e rasteve të korrupsionit nga punonjësit e Policisë Kufitare dhe eliminimin e shkaqeve që sjellin atë;
7. Parandalimi, ndërprerja e shkeljeve dhe abuzimeve dhe kontrolli i veprimtarisë ekonomiko-financiare;
8. Përmirësimi i kapaciteteve të strukturës së auditimit.

Në seksionin e mëposhtëm shtjellohen masat për zbatimin e objektivave të mësipërme, institucionet përgjegjëse, afati i zbatimit si dhe bëhet vlerësimi i tyre bazuar në informacionin e marrë nga burime të ndryshme që nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në formën e një Raporti për Zbatimin e Planveprimit Anti-korrupsion (RZPAK) si dhe me anë të intervistave me aktorë kyç të kësaj strukture. Gjithashtu janë konsultuar edhe materiale të tjera online të vendosura në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme, apo legjislacionin i botuar në faqet e Fletores Zyrtare.

2. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË MASAVE

Objektivi 1: Përmirësimi i mekanizmave dhe mjeteve për hetimin e rasteve të korrupsionit

Masa 1.1: Analiza të përbashkëta me prokurorinë për hetimin e korrupsionit

Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Hetimit të Krimin (DHK), Drejtoria Kundër Krimin Financiar (DKKF)

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: Pjesërisht e zbatuar

Kjo masë adreson përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit me anë të kryerjes së analizave të përbashkëta. Sipas RZPAK¹, bashkëpunimi me prokurorinë është detyrim që rrjedh nga Memorandumi i Bashkëpunimit Nr. 3521, datë 06.05.2009 për krijimin e 6 task-forcave kundër korrupsionit sipas të cilit ky lloj bashkëpunimi parashikohet dhe ndodh në kuader të Njesive të Përbashkëta Hetimore. Janë ndërmarrë analiza të përbashkëta për 308 raste hetimi për veprat e korrupsionit dhe krimin në detyrë sipas ecurisë së hetimit². Megjithatë burimet nuk përcaktojnë numrin e saktë të analizave të përbashkëta me prokurorinë dhe nuk ka referenca të qarta për konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse që përmenden si tregues monitorimi në Plan veprim. Masa vlerësohet si pjesërisht e zbatuar.

Masa 1.2: Përdorimi i teknikave speciale të hetimit për goditjen e korrupsionit.

Institucioni përgjegjës: DHK, DKKF

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Në lidhje me përdorimin e metodave dhe teknikave speciale të hetimit për goditjen e korrupsionit RZPAK vë në dukje se ato janë përdorur në 79 raste hetimi³. Kjo masë adreson rekomandimet e raportit të BE për vitin 2009 i cili thekson se “nevojitet trajnim më i madh dhe një përfshirje më e madhe e policisë së shtetit lidhur me përdorimin e

¹ Raport për zbatimin e strategjisë anti-korrupsion të policisë së shtetit janar-dhjetor 2010, (Informacion i marrë me email nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit më datë 04.04.2011).

² Raportimi i Zbatimit të planit të veprimit për periudhën Janar – Dhjetor 2010, fq 1. Si edhe intervistë me përfaqësues të Seksionit Kundër Korrupsionit në Policinë e Shtetit (datë 30.05. 2011)

³ Shifra e mësipërme nuk mund të krahasohet me atë të vitit të mëparshëm pasi mungon aksesi tek raporti i 2009. Raporti i 2010 nuk jep shifrat e vitit të mëparshëm çka nuk mundëson krahasimin.

teknikave speciale të hetimit”⁴. Megjithatë, raporti analitik i Komisionit thekson se ndonëse teknikat speciale të hetimit po përdoren gjerësisht, shkalla e interceptimit dhe përdorimi i agjentëve civilë janë të limituar në nivelin qendror.

Objektivi 2: Forcimi e zgjerimi i informatizimit, konsolidimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit.

Masa 2.1: Pasurimi dhe shfrytëzimi i bazës së të dhënave të sistemit të informacionit kriminal (MEMEX) me të dhëna dhe informacione për zyrtarë të implikuar në veprime korruptive, zyrtarë të ndjekur penalisht dhe të dënuar për korrupsion dhe krime në detyrë.

Institucioni përgjegjës: DHK, DKKF

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Përsa i përket pasurimit të bazës së të dhënave vërehet se strukturat e Policisë së Shtetit e kanë përmbytur këtë komponent. Në RZPAK theksohet se gjatë vitit 2010 data baza SMIK MEMEX është pasuruar me 781 informacione dhe 308 ngjarje⁵. Në lidhje me shfrytëzimin e MEMEX nga intervistat me përfaqësues të këtij institucioni rezulton se Policia e Shtetit shfrytëzon rregullisht këtë bazë të dhënash⁶. Gjithashtu RZPAK thekson se të dhënat e administruara në këtë database janë shfrytëzuar për të gjitha procedimet penale të hetuara nga strukturat e hetimit të korrupsionit.⁷ Për të bërë të mundur plotësimin e kësaj mase, në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm, Nr.124, datë 09.02.2010, “Për plotësimin e formularëve tip për të dhënat e personit dhe për informacionin policor nga punonjësit e nivelit zbatues në strukturat e Policisë së Shtetit”, është krijuar mundësia e grumbullimit të informacionit nga të gjitha strukturat e policisë, sipas formularëve tip, mbi bazën e të cilëve regjistrohen të dhënat në MEMEX. Kjo ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në pasurimin e të dhënave të databazës. Megjithatë në opinionin e BE-së për vitin 2010, theksohet se ndonëse përdorimi i sistemit MEMEX ka përmirësuar shkëmbimin e të dhënave brenda Policisë së Shtetit, sistemi nuk ndahet me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit⁸. Duke pasur parasysh informacionin në dizpozicion kjo masë konsiderohet si e zbatuar. Megjithatë matja e progresit të zbatimit të masës është problematike për shkak se indikatorit nuk përfshin *element statistikor e cilësor në mënyrë që të matet lehtësisht sa është përmbytur objektivi*.

Objektivi 3: Përmirësimi i procedurave për të rritur efikasitetin e ndjekjes penale

Masa 3. 1: Trajnimi i specialistëve të emëruar pranë 6 task forcave kundër korrupsionit dhe i specialistëve të luftës kundër korrupsionit me teknikat speciale të hetimit.

4 EC, (Brussels, 14.12, 2009), Albania 2009 Progress Report accompanying the Communication from Commission to European Parliament and Council. Enlargement Strategy and Main challenges 2009-2010.

5 Raportimi i realizimit të planit të veprimit për periudhën Janar – Dhjetor 2010, f. 4.

6 Intervistë me përfaqësues të Seksionit Kundër Korrupsionit në Policinë e Shtetit (datë 30.05. 2011).

7 Raportimi i realizimit të planit të veprimit për periudhën Janar – Dhjetor 2010, f. 4.

8 European Commission (Brussels, Commission Staff Working Document. Analytical Report accompanying the Communication from the Commission, the European Parliament and the Council “Commission opinion on Albania’s application for Membership of the European Union COM(2010) 680}.

Institucioni përgjegjës: Departamenti për Trajnimin Policor (OPDAT).

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: Pjesërisht e zbatuar

Në 2009 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit miratoi me urdhër nr. 1409, date 10.12.2009, "Për miratimin e planit të trajnimeve të Policisë së Shtetit për vitin 2010", vazhdimësinë e zhvillimit të trajnimeve gjatë vitit 2010 për punonjësit e policisë të cilët ishin përdorues të Memex. Këto trajnime synonin aktualizimin e njohurive të punonjësve me zhvillimet e mëtejshme të sistemit dhe me nevojat e punonjësve të policisë. Me qëllim bashkërendimin dhe planifikimin e trajnimeve është miratuar Udhëzimi i Përbashkët Nr. 113, date 12.04.2010 për "Planifikimin, Bashkërendimin, Organizimin dhe Zhvillimin e veprimtarisë trajnuese" midis Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Gjithashtu është miratuar Urdhëri Nr.2618, date 18.05.2010 për kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për vitin 2010 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerezore.

Të dhënat zyrtare nga RZPAK tregojnë se OPDAT, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtare si PAMECA, TAIEK kanë zhvilluar gjatë 2010, 15 trajnime me 171 përfitues të strukturave të krimit financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSh) si dhe me specialistët e emëruar pranë task-forcave kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit. Trajnimet janë përqendruar kryesisht në njohjen dhe perfeksionimin e teknikave speciale për hetimin e këtyre veprave penale. Po kështu janë trajnuar 15 oficerë të policisë, të qendrës dhe të rretheve, për përdorimin e sistemit MEMEX. Gjatë vitit 2010 janë trajnuar edhe 19 oficerë policie të strukturave kundër korrupsionit, 4 oficerë të Sektorit në Qendër dhe 15 oficerë të seksioneve të DP të Qarqeve⁹. Kjo masë ka tre tregues monitorimi: Specialistët e trajnuar në 6 task forcat; Rezultatet konkrete të trajnimeve në nivelin e përdorimit të teknikave të reja; Funkcionimi me sukses i task forcave dhe rezultatet e tyre gjatë vitit 2010. Nga informacioni i marrë vërehet se vetëm treguesi i parë është i matshëm dhe është përmbushur. Ndërsa përsa i përket dy treguesve të tjerë nuk ka informacion për nivelin e përmbushjes së tyre. Kjo masë vlerësohet si pjesërisht e zbatuar.

Objektivi 4: Rritja e nivelit goditës së luftës kundër korrupsionit

Masa 4.1: Rritja e numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër korrupsionit

Institucioni përgjegjës: DKKF

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

Masa ka karakter të përgjithshëm dhe synon rritjen e efikasitetit të luftës kundër korrupsionit nga ana e strukturave të policisë. Në lidhje me zbatimin e kësaj mase RZPAK thekson se gjatë vitit 2010 Policia e Shtetit ka evidentuar 384 vepra penale për korrupsion dhe krime të zyrtarëve në detyrë, janë proceduar penalisht 607 autorë, janë arrestuar në flagrancë ose me masë sigurimi arrest në burg 105 prej tyre, janë hetuar në

⁹ Policia e Shtetit, Raportimi zbatimit të masave të planveprimit anti korrupsion janar dhjetor 2010, 5

gjendje të lirë 499 persona dhe 3 janë shpallur ne kërkim¹⁰. Në formulimin e masës përmendet fjala rritje, por shifrat e dhëna gjatë zbatimit janë vetëm për vitin 2010 dhe nuk mundësojnë krahasim për periudhat e mëparshme në mënyrë që të shikohet nese ka ose jo rritje. Në raportin analitik të BE-së për vitin 2010 thuhet se “nëpërmjet implementimit të strategjisë anti-korrupsion dhe plan veprimeve duhet siguruar një vijim solid i hetimeve pro-aktive dhe i ndërmarrjes së veprimeve nga prokuroria si edhe i dënimeve dhe konkluzioneve për rastet e korrupsionit në të gjitha nivelet. Nga intervista e kryer në DPPSh u konstatua se për vitin në vazhdim (janar-maj 2011) nga 50 raste hetimesh pro-aktive¹¹, 24 janë të mbartura nga viti 2010. Kjo tregon se masa ende nuk zbatohet siç duhet dhe është e vështirë të matet rritja e hetimeve pro-aktive. Gjithashtu nuk përcaktohet kush është burimi i buxhetit për zbatimin e kësaj mase.

Objektivi 5: Hartimi i statistikave periodike të ecurisë së ndjekjes penale.

Masa 5.1: Hartimi i statistikave mujore, tre mujore dhe vjetore të korrupsionit dhe krimeve të zyrtarëve në detyrë. Analiza dhe studime të drejtimeve të luftës kundër korrupsionit.

Institucioni përgjegjës: DPPSh, DHK, DKKF.

Afati i realizimit: Gjatë 2010

Statusi: E zbatuar

Bazuar në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm, nr. 251 date 15.02.2008 “Për hartimin e Statistikave të Kriminalitetit”, strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit kanë hartuar statistika mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore mbi numrin e rasteve të evidentuara dhe të referuara në Prokurori.¹² Puna për zbatimin e kësaj mase dhe hartimi i këtyre statistikave është përmendur në mënyrë të vazhdueshme edhe gjatë intervistave të kryera. Po ti referohemi treguesit monitorues masa vlerësohet e zbatuar. Megjithatë, njëra nga mangësitë e vërejtura është transparenca e statistikave të cilat nuk janë lehtësisht të aksesueshme. Përpos kësaj, nuk përcaktohet burimi i buxhetit për zbatimin e saj.

Objektivi 6: Ngritja në nivel më të lartë e bashkëpunimit ndër institucional në luftën kundër korrupsionit.

Masa 6.1: Rritja e bashkëpunimit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis policisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD), SHISH, SHIU etj.

Institucionet përgjegjës: DPPSh, DHK, DPT, ShISH, SHIU, etj

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E pazbatuar

RZPAK thekson se Policia e Shtetit ka respektuar të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga Memorandumet e Mirëkuptimit ndërmjet saj, ShISH, ShKB, Prokurorinë dhe Ministrinë e Financave në lidhje me luftën kundër korrupsionit.¹³ Përfaqësues të

¹⁰ Policia e Shtetit, Raportimi zbatimit të masave të planveprimit anti korrupsion janar-dhjetor 2010, 5

¹¹ Hetime pro-aktive përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera.

¹² Raportim për zbatimin e planveprimit për periudhën janar-dhjetor 2010, 8

¹³ I njëjti informacion për këtë masë theksohet dhe nga intervista me përfaqësues të Seksionit Kundër Korrupsionit në Policinë e Shtetit (datë 30.05. 2011).

projektit PACA sugjerojnë se një nga mangësitë qëndron në faktin se Plani nuk përfshin strukturat e hetimit si psh Prokuroria.¹⁴ Duke patur parasysh që kjo masë ka si tregues monitorimi numrin e shkëmbimeve të informacioneve dhe shpejtësinë e shkëmbimit të informacionit ndërkohë që RZPAK dhe intervistat me përfaqësues të institucionit nuk ofrojnë të dhëna konkrete mbi treguesin e monitorimit të përmendur masa vlerësohet e pazbatuar. Edhe për këtë masë nuk përcaktohet burimi i buxhetit për zbatimin e kësaj mase.

Masa 6.2: Analizimi i punës së përbashkët.

Institucionet përgjegjës: DPPSh, DHK

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Sipas RZPAK gjatë vitit 2010 janë kryer 11 analiza të përbashkëta për goditjen e kontrabandës me Prokurorinë dhe punonjësit e tatimeve dhe doganave, 8 analiza për goditjen penale në fushën e tatimeve me tatimet dhe prokurorinë, 7 analiza të përbashkëta me ShKB për goditjen dhe arrestimin e zyrtarëve të korruptuar.¹⁵ Megjithatë, opinionimi i BE-së për kërkesën e Shqipërisë në Bashkimin Evropian përmend se “një tjetër fushë ku duhet të ketë më tepër rezultate është rritja e bashkëpunimit ndërmjet organeve zbatuese të ligjit me synim eliminimin e fenomenit të korrupsionit.”¹⁶ Kjo masë përsëritet dhe mbulohet edhe në masa të tjera prandaj integrimi i saj sipas rastit dhe heqja e saj si masë e veçantë do të rekomandohej. Masa konsiderohet e zbatuar.

Objektivi 7: Shkëmbimi i informacionit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit për rastet e korrupsionit.

Masa 7.1: Transmetimi i shpejtë i informacionit për rastet e veprat e korrupsionit, strukturës së specializuar të luftës kundër korrupsionit në DKKF.

Institucioni përgjegjës: DKKF

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Policia e Shtetit ka shkëmbyer informacion me DPPP për 10 raste për verifikimin e llogarive bankare për zyrtarët e dyshuar për korrupsion dhe pastrim parash. Po kështu shkëmbimi i shpejtë i informacioneve me ShSh ka finalizuar me sukses 6 operacione policie.¹⁷ Masa vlerësohet e zbatuar. Megjithatë, duhet theksuar se ndërkohë që objektivi dhe masat çojnë në përmirësime cilësore indikatorit është sasior. Prandaj është i nevojshëm një harmonizim i objektivit dhe masës me indikatorin.

¹⁴ Interviste me z. Genc Ibrahim (Projekti PACA), datë 10.05.2011.

¹⁵ Raportim për zbatimin e planveprimit të Plan-veprimit për periudhën janar-dhjetor 2010, 9.

¹⁶ European Commission, 9.11.2010. Communication from the European Commission to the European Parliament and the Council. Commission Opinion on Albania's application for EU membership 10

¹⁷ I njëjti informacion për këtë masë theksohet dhe nga intervista me përfaqësues të Seksionit Kundër Korrupsionit në Policinë e Shtetit (datë 30.05. 2011).

Objektivi 8: Rritja e bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit.

Masa 8.1: Transmetimi i shpejtë i informacionit për rastet e veprave të korrupsionit, strukturës të specializuar të luftës kundër korrupsionit në DKKF.

Institucioni përgjegjës: DPPSH

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Sipas RZPAK gjatë 2010 janë shkëmbyer 8 informacione me Interpolin dhe oficerët ndërlidhës të policisë me Kroacinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Greqinë, Italinë, Zvicrën dhe Anglinë¹⁸. Sidoqoftë vlen të theksohet se institucionet përgjegjëse për këtë masë nuk janë specifikuar qartë për cili departament brenda DPPSh është përgjegjës.

Objektivi 9: Promovimi i praktikave antikorrupsion dhe i operacioneve policore për goditjen e korrupsionit

Masa 9.1: Prezantimi dhe publikimi i rasteve dhe praktikave më të mira për goditjen e korrupsionit.

Institucioni përgjegjës: DPPSh, DHK, DKKF.

Afati i realizimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Gjatë vitit 2010 janë bërë 37 njoftime mediatike me konferenca për shtyp nga DPPSh dhe Drejtoritë e Policisë në Qarqe për rastet e finalizimit të operacioneve policore dhe përfundimit të hetimit dhe dërgimin e çështjeve në gjykatë. **Indikatori matës i këtij objektivi mbetet i përgjithshëm ndaj duhet specifikuar.** Masa vlerësohet e zbatuar.

Ndryshe nga Blloku i parë, progresi i Drejtorisë së përgjithshme të policies së shtetit në kuadër të Bllokut të dytë – Parandalimi i korrupsionit në strukturat e policisë së shtetit – shfaqet mjaft i kënaqshëm ku të gjitha masat e parashikuara rezultojnë të adresuara.

Objektivi 1: Rritja e integritetit dhe përmirësimi i standardeve të punës së punonjësve të policisë së shtetit nëpërmjet zbatimit me rigorozitet të akteve normative të hartuara në mënyrë specifike për luftën kundër korrupsionit në strukturat e policisë së shtetit.

Masa 1.1: Zbatimi i Rregullores së Disiplinës dhe i Letër Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm, dt. 26.11.2009.

Institucionet përgjegjës: DPPP, Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP).

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Në RZPAK theksohet se DSP gjatë vitit 2010 ka administruar 411 shkelje disiplinore të punonjësve të policisë (231 të lehta dhe 180 të rënda). Masat e dhëna për shkeljet e rënda janë: përjashtim nga Policia e Shtetit (37 raste), largim nga puna (3 raste), ulje në një gradë deri në 12 muaj (8 raste), pezullim pa pagesë deri në 30 ditë (33 raste), shtyrje

¹⁸ Raportim i zbatimit të masave të planveprimit anti korrupsion, fq. 12.

e afatit të gradimit deri në 12 muaj (50 raste)¹⁹. Megjithatë, nuk mund të bëhet krahasimi me të dhënat e vitit të mëparshëm për të parë më konkretisht rritjen e integritetit dhe rritjen e standardeve të punonjësve të policisë. Masa vlerësohet e zbatuar.

Masa 1.2: Kryerja e Inspektimeve periodike nga Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP)

Institucionet përgjegjës: DPPP, DSP.

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Gjatë vitit 2010 DSP ka kryer 33 inspektime ne drejtoritë e policisë se qarqeve, drejtoritë rajonale te kufirit e migracionit si dhe komisaritet e policisë vartëse te këtyre strukturave dhe ka dhënë 88 rekomandime për përmirësimin e punës. Masa vlerësohet e zbatuar.

Objektivi 2: Reduktimi i mundësisë së punonjësit të PKM për akte korruptive nëpërmjet minimizimit të Transaksioneve të ligjshme financiare në PKK.

Masa 2.1: Minimizimi i kryerjes së transaksioneve të ligjshme financiare në Pikat e Kalimit kufitar në zbatim të: Ligjit Nr. 9959 dt. 17.07.2008 “Për të Huajt”, VKM Nr. 362 dt. 01.04.2009 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSh”, VKM Nr. 362 dt. 27.04.2009 “Për një shtesë në VKM 362 dt. 01.04.2009 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSh.”

Institucioni përgjegjës: DPPSh, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit (DKM)

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Në veprimet që janë ndërmarrë për zbatimin e saj përmenden ndjekja e zbatimit të ligjit për moslejimin e transaksioneve ligjore në kufi dhe monitorimi i rasteve për lëshim vize tranzit të marinarëve. Gjithashtu theksohet se me anë të Udhëzimit të Përbashkët i Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror nr. 2102, date 03.08.2009, “Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e lëshimit te vizave” procedura për lëshimin e vizave është standardizuar dhe se rastet e pajisjes me vizë pasqyrohen në deklaratën

¹⁹ Për shkelje disiplinore të parashikuara në nenin 11, pikat 5, 8,10 dhe 12 që kanë të bëjnë me veprimet korruptive nga punonjësit e policisë janë 14 raste; Për shkelje disiplinore të parashikuara në nenin 11, pikat 5, që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve të pahijshme, janë hetuar 16 raste; Për shkelje disiplinore të parashikuara në nenin 11, pikat 10, që kanë të bëjnë përdorimi i detyrës së punonjësit të policisë për interesa private janë hetuar 5 raste; Për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 11, pika 6, që bën fjalë për moszbatimin e urdhrave të ligjshëm që ka sjellë pasoja, janë hetuar 13 raste; Për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 11, pika 6 dhe 12 që bën fjalë për moszbatimin e urdhrave të ligjshëm që ka sjellë pasoja dhe mosushtrim i kompetencave te policisë, janë hetuar 8 raste; Për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 11, pika 11 që bën fjalë për shkeljen e kërkesave e rregullave gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për 3 raste; Për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 11, pika 5 e 14 që bën fjalë për kryerjen e veprimeve te pahijshme dhe përdorimin e paligjshëm ose të paarsyeshëm të forcës, janë hetuar 3 raste; Për shkelje te tjera te neneve te rregullores se disiplinës janë hetuar 128 raste.

ditore të punës²⁰. Sipas përfaqësuesve të DKM, në pikat kufitare ka zyra të vecanta pagesash (për gjobat dhe për vizat). Sipas të njëjtit burim, dhënia e vizave në kufi ndodh vetëm në rastet që rekomandohen si të interesit kombëtar nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), në zbatim të ligjit për të huajt. Gjithashtu, lista e çmimeve për vizat miratohet nga Këshilli i Ministrave. Një veprim tjetër i ndërmarrë është standardizimi i kryerjes së pagesave të gjobave në lekë. Gjithashtu, gjobat dhe raporti që i shoqëron ato hidhen në sistem dhe janë të aksesueshme nga të gjitha hallkat e sistemit, prej drejtorive rajonale e deri në nivel qendror²¹. Mbështetur në informacionin e mësipërm masa konsiderohet e zbatuar.

Objektivi 3: Rritja e kapaciteteve të Punonjësve të PKM për luftën kundër korrupsionit në kufi nëpërmjet trajnimeve.

Masa 3.1: Kryerja e trajnimeve për mbikëqyrësit e PKM. Njohja në vazhdimësi me aktet normative për luftën kundër sjelljeve jo etike.

Institucioni përgjegjës: DPPSh, DKM

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Në Qendrën e Formimit Policor gjatë periudhës 15 mars - 15 korrik 2010 është kryer trajnimi 4 muaj me 20 punonjës të Drejtorive Rajonale të Kufirit dhe Migracionit për zbatimin e Kodit të Etikës Policore, të Sjelljes dhe Anti-korrupsionit. Gjatë periudhës korrik-shtator 2010, në të gjitha DRK&M është kryer trajnimi "Për anti-korrupsionin dhe standardet etike "me punonjës të gradave inspektor deri në komisar që u zhvillua në 3 faza dhe trajnoi 1422 punonjës. Gjatë vitit 2010 trajnimet e specialistëve të mbikëqyrjes dhe specialistëve të tjerë të DKM në nivel rajonal dhe qendror zhvillohen sipas një kurrikule e cila përfshin edhe tema anti-korrupsion. Masa konsiderohet e zbatuar.

Objektivi 4: Monitorimi on-line i aktivitetit të punonjësve të PKM në PKK.

Masa 4.1: Instalimi i kamerave dhe pajisjeve teknike në kabinat e pikave të kalimit të kufirit për monitorimin e aktivitetit dhe lidhja me monitorët në Sallën e Përgjithshme Operative në Drejtorinë e Përgjithshme

Institucioni përgjegjës: DPPSh, DKM

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Zbatimi i projektit të Shërbimit Doganor në kuadër të programit IPA 2008 për vendosjen e sistemit të mbikëqyrjes me kamera ka mundur kamera që përdoren nga të dy shërbimet në 10 PKK. Sipas DPKM, të gjithë PKK janë pajisur me kamera gjatë periudhës 2008-2010 dhe të gjitha materialet filmike kalojnë në Sallën Operative të DPPSh, e cila monitoron veprimet e policëve dhe doganierëve të PKK drejtpërdrejt në orët e pikut dhe 24 orë të regjistruara nëpër kasete²². Të njëjtën gjë konfirmon edhe raporti i BE për vitin 2010. Masa vlerësohet e zbatuar.

20 Raportimi i zbatimit të masave të planveprimit anti korrupsion janar dhjetor 2010, 23

21 Intervistë zhvilluar në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, dt. 25. 4. 2011

22 Intervistë zhvilluar në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, dt. 25. 4. 2011

Objektivi 5. Kontrolli i aktivitetit të punonjësve të PKM në PKK për regjistrimin e hyrje/daljeve të shtetasve dhe mjeteve.

Masa 5.1: Analiza e aktivitetit të punonjësit të PKM në PKK nëpërmjet sistemit TIMS

Institucioni përgjegjës: DPPSh, DKM

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Dy specialistë të DKM monitorojnë nëpërmjet TIMS procesin e regjistrimit të shtetasve që hyjnë/dalin nëpërmjet PKK-ve. Gjithashtu Drejtoria e Mbrojtjes të të Dhënave nëpërmjet programit informatik ka monitoruar procesin e evidentimit të hyrje daljeve në kufi. Gjatë vitit 2010 Sektori i Migracionit ka monitoruar në TIMS hyrjet dhe daljet e 4700 shtetasve të huaj që kanë aplikuar për leje qëndrimi dhe kanë rezultuar të regjistruar në sistem. Gjithashtu edhe raporti analitik i BE-së (2010) thekson se “përmirësimi i infrastrukturës në PKK po vazhdon dhe se aktualisht të 24 PKK-të janë të lidhura me sistemin TIMS që u ofron atyre akses tek baza e të dhënave kombëtare mbi dokumentet dhe personat e kërkuar dhe tek baza e të dhënave e INTERPOLIT.

Objektivi 6: Identifikimin e rrugëve dhe metodave për uljen e rasteve të korrupsionit nga punonjësit e Policisë Kufitare dhe eliminimin e shkaqeve që e sjellin atë.

Masa 6.1: Vlerësimi i riskut për të identifikuar fushat e prekshme nga korrupsioni

Institucioni përgjegjës: DKM

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Zyra e Analizës së Riskut në DKM kryen analiza të riskut për shkaqet dhe arsyet që kanë sjellë praktika korruptive në DKM. Gjatë vitit 2010 janë kryer 52 analiza në nivel lokal, 12 në nivel rajonal dhe 2 në nivel qendror²³. Gjithashtu, ka raporte 3 dhe 6 mujore nga DP rajonale dhe në bazë të tyre përpunohet një raport vjetor prej DKM në DPPSh. Situatat analizohen prej Zyrës së Analizës së Riskut, e cila përgatit raporte mujore në lidhje me analizimin e rasteve konkrete.²⁴ Një mangësi që vërehet sa i përket kësaj mase është se nuk specifikon burimet e buxhetit. Masa konsiderohet e zbatuar.

Objektivi 7: Parandalimi, ndërprerja e shkeljeve dhe abuzimeve dhe kontrolli i veprimtarisë ekonomiko-financiare;

Masa 7.1: Auditimi i plotë dhe tematik i aktivitetit ekonomiko-financiar të strukturave të policisë

Institucioni përgjegjës: Sektori i Auditit të Brendshëm (SAB)

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Status: E zbatuar

Për vitin 2010 janë kryer nga SAB 15 auditime të plota dhe 38 auditime tematike në drejtoritë dhe komisaritet. SAB ka dhënë 326 masa dhe rekomandime nga te cilat 71 masa për zhdëmtim dhe 255 masa organizative e disiplinore. Gjithashtu është

²³ Raportimi zbatimit të masave të planveprimit anti korrupsion janar dhjetor 2010, 27

²⁴ Intervistë zhvilluar në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, dt. 25. 4. 2011

konstatuar shkelje e rregullave për prokurime publike në dy raste dhe këto i kanë kaluar për ndjekje penale APP²⁵. Krahasuar me vitin 2008 kur auditet kryheshin dhe deri një herë në 5 vjet sot ato kryhen në intervale kohore që variojnë nga 1 herë në gjashtë muaj deri në një herë në 18 muaj. Kjo ka kontribuar që dëmi (krimi ekonomik) i raportuar nga auditet që janë kryer brenda policisë të ulet nga 87 000 000 në vitin 2008 në 22 357 000 në vitin 2010²⁶. Ndonëse masa konsiderohet e zbatuar vlen të theksohet se ajo ka karakter rutinor pasi është një nga detyrat e Auditit të Brendshëm. Një masë me karakter sasior si p.sh numri i rasteve të kapura të korrupsionit të krahasuara me një vit më parë apo sa raste auditesh janë shndërruar në politika (psh urdhra Ministrash etj) do të ishte më indikative. Nga ana tjetër, vërehet se treguesit e monitorimit nuk mund të vlerësojnë masën e përcaktuar.²⁷

Objektivi 8: Përmirësimi i kapaciteteve të strukturës së auditimit

Masa 8.1: Trajnimi i specialistëve të Sektorit të Auditimit

Institucioni përgjegjës: SAB

Afati i Zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Janë realizuar 40 orë trajnimesh për ngritjen profesionale, njohjen me legjislacionin në fuqi dhe eksperiencat ndërkombëtare të Auditimit, si edhe trajnime për 4 specialistë të auditimit nga PAMECA. Gjithashtu evidentohet edhe trajnimi me 18 punonjës të qendrës dhe rretheve me grada të ndryshme për “Përvetësimin e Manualit të Ri të Auditit të Brendshëm”, si dhe disa trajnime të tjera tematike për buxhetin, Komisionin e Këshillit Civil etj por nuk ofrohen shifra të sakta për pjesëmarrjen. Përfaqësues zyrtarë theksojnë se trajnimet kanë aftësuar më tej audituesit çka dëshmohet nga ulja e dëmit ekonomik²⁸.

3. VLERËSIMI CILËSOR I PROGRESIT

Në përgjithësi ka një përputhshmëri të qartë midis objektivave të përcaktuara për Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe masave që lidhen me zbatimin e tyre. Megjithatë, ka raste kur nuk është e qartë sesi masa përkatëse do kontribuojë në luftën kundër korrupsionit. Disa objektiva janë shumë të përgjithshëm dhe mund të zërthehen në më shumë objektiva e pwr pasojw nw mw shumw masa konkrete. Shumë prej masave kanë përfshirë aktivitete rutinore, raporte apo inspektive të cilat përsëriten disa herë.

Ne rastet e masave që lidhen me përmirësimet infrastrukturale treguesit janë të matshëm, ndërsa në raste të tjera treguesit mbeten abstrakt dhe në mungesë të shifrave krahasimore, monitorimi bëhet i vështirë. Gjithashtu, një pjesë e tyre nuk

25 Raportimi i zbatimit të planveprimit anti-korrupsion janar -dhjetor 2010, 26

26 Intervistë në Seksionin e Auditit të Brendshëm, datë 13.04.2011

27 Treguesit e monitorimit janë: masa dhe rekomandime për përmirësimin e punës të aktivitetit ekonomik e financiar; hartimi i përgjithësimeve për problematikat e konstatuara

28 Intervistë në Seksionin e Auditit të Brendshëm datë. 13.04.2011

shoqërohen me specifikimin e burimeve të buxhetit për arritjen e tyre, gjë që vë në pikëpyetje nivelin e zbatimit të masës. Në total vetëm 8 masa kanë të përcaktuar qartë burimin e buxhetit. Objektivat dhe masat me karakter të përgjithshëm e vështirësojnë adresimin e tyre me indikatorë specifikë sic është rasti i masës 1.2, 2.1 ose 5.1 tek blloku I, etj. Më konkretisht:

- Tek masa 1.2 mbi përdorimin e teknikave speciale për hetimin e korrupsionit duke patur parasysh që keto teknika janë forma më e mirë për zbulimin e rasteve korruptive, **indikatorët duhet të jenë shumë specifikë**, psh të mos jepet vetëm numri i rasteve kur janë përdorur teknikat speciale të hetimit por edhe sa prej rasteve në fjale janë proceduar më tej
- Tek masa 2.1 nuk mjafton vetëm pasurimi i databazës MEMEX me të dhëna për të luftuar korrupsionin por psh duhet parë sa herë ka qenë i dobishëm për hetimin e krimit ekonomik shfrytëzimi i databazës së të dhënave MEMEX.
- Tek Masa 5.1 mbi prodhimin e statistikave mujore, 3 mujore dhe raporteve periodike nuk specifikon bërjen publike dhe lehtësisht të aksesueshme të këtyre statistikave por thjesht hartimin e tyre.

Përsa i përket ndërgjegjësimit së administratës, ka struktura që janë relativisht skematikë dhe stepen të flasin qartë përsa i përket nivelit të zbatimit të masave, ose flasin vetëm për masa të përmbushura, zhvillime pozitive dhe nuk janë realiste në evidentimin e problematikave, duke krijuar përshtypjen se çdo gjë shkon mirë. Edhe kur masat janë zbatuar pjesërisht ata tentojë të justifikojnë moszbatimin në kohë duke mos e konsideruar këtë si problematikë.

Bashkëpunimi ndër-institucional në rastin e policisë së shtetit ka rezultuar në përgjithësi të jetë pozitiv si me struktura të tjera ashtu dhe me aktorë në rajon. Edhe në raportet e progresit të BE (2008, 2009 dhe 2010) identifikojnë si problematik bashkëpunimin ndërmjet policisë së shtetit dhe strukturave të tjera (prokuroria).

Çështja e matshmërisë së efekteve dhe ndikimit të masave në funksion të luftës kundër korrupsionit shfaqet pjesërisht problematike për masat e Policisë së Shtetit. Në pjesën e masave që u referohen miratimit të udhëzimeve, trajnime, pajisjeve me kamera, raporte apo inspektive objektivat janë të matshme. Disa masa nuk janë të matshme pasi nuk kanë karakter sasior por cilësor dhe treguesit e monitorimit janë të paqartë. Në rastet kur masa i referohet rritjes së goditjes kundër korrupsionit, rritjes së bashkëpunimit ndër-institucional etj., shpesh raportohet se numri është rritur pa dhënë specifikime sasiore ose jepen vetëm shifrat më të fundit (2010) të pashoqëruara me detaje për vitet e shkuara çka do të mundësonin krahasimet përkatëse.

4. REKOMANDIME

Duke u bazuar tek analiza e mësipërme mund të jepen këto rekomandime për përmirësim:

- Përcaktimin e afateve të qarta për zbatimin e masave pasi vërehet se të gjitha masat kanë si afat zbatimi gjithë vitin janar-dhjetor 2010.
- Përcaktimi i qartë i burimeve dhe sasisë së buxhetit. Në 20 vetëm 8 masa kanë përcaktuar burimin e buxhetit.
- Hartimi i objektivave duhet të jetë më specifikë pasi disa prej tyre janë të përgjithshëm. Shembuj konkretë mund të jenë objektiva që përmbajnë fjalë të tilla si Rritja e integritetit dhe përmirësimi i standardeve të punës së punonjësve nëpërmjet zbatimit të akteve normative. Objektivi 2.1. ose objektiva të tjerë si p.sh. Identifikimin e rrugëve dhe metodave për uljen e rasteve të korrupsionit nga punonjësit e Policisë Kufitare dhe eliminimin e shkaqeve që e sjellin atë, Promovimi i praktikave anti-korrupsion etj. ku objektivat përgjithësues vërehen më qartësisht.
- Hartimi i objektivave dhe masave me tregues monitorimi të matshëm dhe qartësisht të lidhur me luftën ndaj korrupsionit si edhe eliminimi i masave me karakter rutinor.

5. BURIMET

Burime parësore:

1. VKM Nr. 1561, datë. 03.10.2008 “Për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale për parandalimin, Luftën Kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen transparente 2008-2013” [On-line] <http://www.ikub.al/LIGJE/810030003/Article-PeR-MIRATIMIN-E-STRATEGJISE-NDeRSEKTORIALE-PeR-PARANDALIMIN-E-LUFTeN-KUNDeR-KORRUPSIONIT-DHE-PeR-NJE-QEVERISJE-TRANSPARENTE-2008-2013-.aspx>. Parë për herë të fundit në 2 maj 2011
2. VKM Nr. 362. datë. 1.04.2009 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë” Fletore zyrtare nr. 74, 22 maj 2009 [On line] . Parë për herë të fundit në 5 maj 2011
3. VKM nr. 431, datë 27.4.2009, “Një shtesë në VKM Nr. 362 dt. 1.04.2009 Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë” [On-line] http://www.asp.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=302%3Anje-shtese-ne-vendimin-nr362-date-142009-te-keshillit-te-mintstrave-per-percaktimin-e-kriterëve-procedurave-dhe-te-dokumentacionit-per-hyrjen-qendrimin-dhe-trajtimin-e-te-huajve-ne-republikën-e-shqiperise&catid=95%3Akufiri-a-migracioni&Itemid=262&lang=sq Parë për herë të fundit më :5 maj 2011
4. Udhëzim i Përbashkët i Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brendshme Nr. 113 datë 12.04.2010 për “Organizimin dhe Zhvillimin e Veprimtarisë trajnuese” [on-line <http://www.moi.gov.al/>]. Parë për herë të fundit në 15 prill 2011

5. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1409, date 10.12.2009, "Për miratimin e planit të trajnimeve të Policisë së Shtetit për vitin 2010" [on-line <http://www.moi.gov.al/>. Parë për herë të fundit në 15 prill 2011
6. Urdhër i Ministrit të Punëve të Brendshme. Nr.2618, datë 18.05.2010 "Për kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për vitin 2010 midis Drejtorise së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorise së Inspektimit dhe Burimeve Njerezore". [on-line] <http://www.moi.gov.al/>. Parë për herë të fundit në 15 prill 2011

Strategji dhe Planveprime

1. Këshilli i Ministrave, "Strategjia Ndërsektorale për Parandalimin, Luftën Kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen Transparente 2008-2013".
2. Plani i Integruar i Minsitrisë së Punëve të Brendshme 2010. [On-Line] <http://www.moi.gov.al/drupal1/pdf/planiintegruar02.04.2010.pdf>. Parë për herë të fundit në 25 prill 2011
3. Strategjia ndër-sektorale e Luftës Kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente Plani i Veprimit i Integruar 2010.

Raporte të pa publikuara

4. Policia e Shtetit Raport për zbatimin e strategjisë anti-korrupsion të policisë së shtetit janar-dhjetor 2011, (informacion i marrë me email nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit)

Burime dytësore

Raporte të Komisionit Europian

1. European Commission, Commission Staff Working Document. Analytical Report accompanying the Communication from the Commission, the European Parliament and the Council "Commission opinion on Albania's application for Membership of the European Union COM(2010) 680} [On-line] http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargement/47f_en.htm Parë për herë të fundit në 1 maj 2010
2. European Commission, 9.11.2010. Communication from the European Commission to the European Parliament and the Council. Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union {SEC(2010) 1335}

Studime

- Reed, Quentin (2010a) "Background And Guidelines For Drafting The Action Plan For 2011-2013", Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, November 2010
- Reed, Quentin (2010b) "The 2010 Anti-Corruption Action Plan, Recommendations For Next Steps And Further Assistance" Technical paper, Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, July 2010

Reed, Quentin (2010c) "Comments on 2010 Anti-corruption Action Plan and Recommendations for Future Action Plans", Technical paper, Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, June 2010

Swedish International Development Cooperation Aid Agency (*Sida*) 2008 "Albania Anti Corruption Study", conducted by Ramboll Management Consulting, Denmark.

<http://www.aidharmonisation.org.al/skedaret/1203101753-SIDA%20Albania%20Anti-Corruption%20Study%20-%20Revised.pdf>

Adresa interneti

Ministria e Punëve të Brendshme: www.moi.gov.al

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit: <http://www.asp.gov.a>

Këshilli i Ministrave: www.keshilliministrave.al/

Qendra e Publikimeve Zyrtare: www.qpz.gov.al

PAMECA www.pameca.org.al/

Kwshilli i Evropës www.coe.al/

Delegacioni i Komisionit të Komunitetit Evropian në Shqipëri:

http://eeas.europa.eu/delegations/albania/index_sq.htm